



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:247584

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05473691

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.957/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm, sipas Gjyqtarit i vetëm gjykues Leon Përlaska, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurit G. Th., për shkak të veprës penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së, e duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm nën shenjen PP/II Nr. 2124/21 të dt. 29.11.2021, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor gjyqësor të mbajtur me dt. 11.03.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit G. Th. me mbrojtësin e tij av. Lulzim Balaj, me dt.11.03.2024 morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 19.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

G. TH., i lindur me datën në fsh. J. K. Pejë, tani me banim në Pejë rr. ”Sh. B.” nr. 2 , i biri i B. dhe nënës N., e vajzërisë Z., i identifikuar në bazë të numrit personal, posedues i nr. të telefonit 044/...-..., pensioner, e ka të kryer shkollën e mesme të artit në Pejë, i martuar baba i gjashtë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës,

Konform nenit 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPPRK-së:

REFUZOHET AKTAKUZA

Gjëja së:

Pas Prillit 2019 e në vazhdimësi gjer me dt. 06.07.2021 rreth orës 12:25 në fsh. K. K. Pejë, përkatësisht vendin e quajtur L., zonë e mbrojtur – parku kombëtar, “Bjeshkët e Nemuna”, si pronar, ndërton një objekt pa leje për të cilin kërkohet leja e tillë në bazë të ligjit për ndërtim¹ dhe atë nenit 7 dhe 14, në atë mënyrë që, pasi i pandehuri Gani në vendin e lartcekur përkatësisht në parcelën P-.....-.....-...., edhe pse fillimisht nuk kishte marrë leje ndërtimore, fillon ndërtimin e një shtëpie tri katëshe me bazë betoni, ndërsa muret nga guri, ku pasi e mbulon me kulm, hetohet nga Policia e Kosovës dhe zyrtarët e DAPK-së,

- me çka kishte për të kryer veprën penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykatë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i përgjithshëm me dt. 29.11.2021 ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II Nr. 2124/21, kundër të pandehurit G. Th., për shkak të veprës penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor gjyqësor me dt. 11.03.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit G. Th., së bashku me mbrojtësin e tij av.Lulzim Balaj i caktuar sipas detyrës zyrtare dhe të dëshmitarëve J. L., B. N.dhe A. M..

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka dëgjuar të dëshmitaret J.L., B. N. dhe A. M., ka administruar provat materiale – formale të propozuara nga ana e Prokurorit të Shtetit në aktakuzë si dhe është dhënë mbrojtja e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit Dorjan Juniku në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: Pas administrimit të provave material edhe personale të përshkuara si më lartë, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor

¹ Ligji Nr. 04/L-110.

kryesor me asnjë provë nuk u vërtetuar se këtu i akuzuari G. Th., ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe këtë konkludim mbështesim në faktet si në vijim: Nuk është kontestues fakti se me dt.06.07.2021, rreth orës 12.-25 minuta, pylltari dëshmitari J. L., B. N. dhe A. M., kane kryer së bashku me Policinë, një kontroll në fsh.K., përkatësisht në vendin e quajtur “Leqinatë”, pjesë e parkut kombëtar, ku gjatë këtij kontrolli, kanë hasur në një objekt të ndërtuar – shtëpi tre katëshe, e ndërtuar nga material i fortë – guri, e cila më pas është konstatuar se është ndërtuar nga pronari i saj këtu i pandehuri G., i cili për këtë objekt ndërtimi nuk ishte i pajisur me leje ndërtimi. Në rastin konkret nga deklaratat e dëshmitareve të sipër shënuar – pylltarëve të dhëna gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor kryesor, nuk u vërtetua se këtu i akuzuari ka ndërtuar shtëpinë në vendin lartcekur gjatë vitit 2019, e tutje, nga se njëzëri deklaruan se nuk janë të sigurt dhe nuk mundë të ofrojnë asnjë siguri se ky objekt është ndërtuar prej vitit 2019, e tutje, e ku sidomos dëshmitari J. L., deklaroi se ky objekt ka mundësi të jetë ndërtuar edhe shumë vite më parë, mirëpo shtoj se edhe për këtë nuk është shumë i sigurt. Edhe pse në aktakuzë si provë materiale është përfshirë edhe orto-foto nga gjeo portali i bërë në vitin 2018, në rastin konkret nga këto orto-foto, nuk mundë të vërtetohet me asgjë lidhur me faktin nëse në vitin 2018, ka pas ose jo objekt të ndërtuar në parcelën me nr....-..., nga se nga foto dokumentacioni i orto fotove nuk shifet dhe nuk mundë të konstatohet se gjatë vitit 2018, ka pas ndonjë objekt të ndërtuar ose jo në këtë parcelë. Andaj nga se u tha më lartë, në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 7 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, të cilat na obligojnë që tërësisht dhe saktësisht të vërtetojmë gjendjen faktike, të marrim parasysh edhe rrethanat të cilat shkojnë në favor të të pandehurit nën 5 par.1 të KPPRK-së, nenit 6 të KEDNJ, nenit 14 të PNDCP, instrumente këto nacionale dhe ndërkombëtar të cilat na obligojnë në zbatimin e parimit të gjykimit të drejtë, nenit 3 par.2 të KPPRK-s nga i cili konsistojë parimi indubio-proreo, respektivisht ekzistojnë mëdyshje lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen e që në këto rast Ligji zbatohet në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij, nenit 24 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, në të cilën ligjvënësi ka përcaktuar se çdo kush është i barabartë para ligjit dhe gëzon mbrojtje ligjore pa diskriminim si dhe nenit 51 të KPPRK-së, heqi dorë nga ndjellja me mëtutjeshme penale kundër të pandehurit G. Th.. për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj, meqenëse Prokurori i Shtetit hoqi dore nga aktakuza PP/II Nr. 2124/21 të dt. 29.11.2021, dhe nga ndjekja penale ndaj të pandehurit G. Th., e duke pas parasysh nenin 362 par. 1 nën par.

1.1 të KPPRK-së² si dhe faktin së tërheqja e aktakuzës eliminon bazën juridike për vazhdim të gjykimit³, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Konform nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykatë.

Andaj, nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.957/21, me datë 19.03.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:

Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

² Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

³ *Nemo iudex sine actore.*